



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

### **Nr. 32**

Datë: 19. 11. 2022. Ora: 18:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Vesa Xharra, drejtoreshë u.d., e ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

**1.** Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

**2.** Aktivitetet e ZRCKFSP

-Kufizimi i shpenzimeve të fushatës për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në komunat Lepsaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut

**3.** Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Operacione Zgjedhore

- Shqyrtimi dhe miratimi i specifikimeve teknike për shtypjen e fletëvotimeve

Këshilli për Çështje Ligjore

Njoftim për zëvendësim të anëtareve të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut, dhe Zubin Potok

**4.** Të ndryshme!

---

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Pasi që kryetari paraqiti rendin e ditës, ai pyeti nëse anëtarët kanë diçka lidhur me agjendën...

**Alim Rama:** Në agjendë po mundon njoftimi lidhur me Listën Votuese...! Dhe, kjo ishte dashur të jetë pika e parë: “lista preliminare e votuesve”...

**Kreshnik Radoniqi:** A ka dikush tjetër, nëse jo, e miratojmë rendin e ditës. Me 9 vota për, miratohet rendi i ditës.

## **2. Aktivitetet e ZRCKFSP**

Kufizimi i shpenzimeve të fushatës për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicë e Veriut:

**Vesa Xharra**, drejtoreshë u.d., e ZRCKFSP, tha se e keni pasur materialin e aktiviteteve të zyrës, dhe ato kanë filluar të rrjedhin menjëherë më datën 15, pra të gjitha informacionet i keni në imell. Mund të them se afati për deklarimin e koalicioneve ka përfunduar më 17, ndërsa nuk kemi pranuar asnjë aplikacion për deklarim të ndonjë koalicioni... Afati tjetër, që ka përfunduar sot në ora 4, ai për deklarim të mos pjesëmarrjes në zgjedhje, dhe janë bërë disa deklarime nga: Serbska Lista, Fjala, Demokratska Stranka “Vatan”, Socialdemokratska Unija, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës etj.

Sot, kemi pranuar edhe deklarimin e iniciativës Balli, Demokratska Stranka Boshnjaka, Lëvizja për Bashkëveprim dhe, KDTP. Duhet të theksoj, tha Xharra se, asnjëra nga këto parti, veç Listës Serbska nuk kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit lokale...

Të hënën, përfundon afati për aplikim dhe certifikim të subjekteve pjesëmarrës, por deri më sot, kemi pranuar vetëm një aplikim nga Iniciativa Qytetare “Mitrovica” nga Mitrovica e Veriut me kandidat për kryetar komune Betim Osmani.

Nuk kemi pranuar asnjë aplikim për vëzhgues !

Gjithashtu, është edhe vendimi për kufizimin e shpenzimeve të fushatës, dhe këtu nuk ka ndonjë ndryshim, pra është 0.50 cent për votues... KQZ, jo më larg se pesë ditë pas shpalljes së zgjedhjeve duhet ta miratojë kufizimin e shpenzimeve të fushatës...

**Kreshnik Radoniqi**, pyeti se a ka ndokush diçka, rreth këtij procesi ? Nëse jo, e hedh në votim...?

**Alim Rama**, së pari, unë kam dërguar imell se afatet, plani i rekrutimit, plani operacional nuk janë në dakordancë me realitetin në terren...! Afatet janë ligjore, të drejta por gjanat nuk janë diskutu, nuk janë debatue në këshilla. Nesër përfundon afati i nominimit të KKZ-ve, zgjedhjet janë shpallur të hënën në mbrëmje, të hënën përfundon afati për kandidatura – pesë ditë afati për nominimin e subjekteve, 17 ditë për trajtimin e çështjeve nga ana e KQZ-së, plani i buxhetit që lidhet me rekrutimin e stafit...

Buxheti është aprovuar mbrëmë, KQZ ka hy në obligime ligjore, e ka punësua stafin, së paku në kam pa në zyre 10 veta...

Jemi tu fol për 74 vendvotime... ( kemi një planifikim në c'akordancë me realitetin) Te informimi publik, 30 mijë euro është parapa buxheti, tre veta shtesë...të gjitha këto nuk janë në proporcion me zgjedhjet e kaluara...për 2.5% në proporcion me 1.8 milion të votuesve..

Nuk kemi hapësirë për debat, limitet janë të përcaktuara me ligj, numri i votuesve është ai që është, mirëpo tash një problem nuk mund ta vendosim me një problem tjetër...

Dje, ne e kemi pa vendimin që janë shpërbë edhe dy kuvende ! Nuk them që ne duhet të marrim masa deri sa presidentja nuk shpallë zgjedhje, por ne mundemi me ba punë paraprake ose përgatitore...

Puna është që këto çështje nuk janë trajtua, veç janë sjellë me ni imell...veç janë trajtuare me: a, jeni për këto pika: 1, 2, 3, 4... Këto janë simulime...E, kur është dashtë me i trajtua, nuk i kemi trajtua...

Duhet mu ditë prioritetet...! Nuk ka pas debat për asnjë çështje, sa korrekte...

**Kreshnik Radoniqi**: A e votuam shpenzimin e kufizimit të fushatës...?

**Gordana Llaban**: Pajtohem...

**Sami Hamiti**, po e votuam...

**Kreshnik Radoniqi**: Atëherë, është miratuar vendimi për kufizimin e shpenzimeve të fushatës në 0.50 cent.

**Sami Hamiti**, tha se ka qenë afat i shkurtër, por kjo s'është hera e parë që vendosim kështu...! Çështjet e stafit, tani jemi në një situatë më specifike, dhe duhet pak konsideratë se atje nuk i kemi KKZ-të aktive...Unë, me vetëdije e kam votue...dhe, në situatën që jemi, mendoj se numri i stafit është adekuat...

E kemi votue, edhe pse dikush ka qenë kundër...por, janë zgjedhje të jashtëzakonshme...

**Sami Kurteshi**, tha se po, duhet ti bëjnë punët...Unë, kam pasur besim të plotë në Sekretariatit dhe kam votue...! Por, me planin nuk jam marrë ama, vërejtje po bëhen...por, mos të ketë lëshime...! Ama, të arsyetohen veprimet...

**Ibrahim Selmanaj**: Unë mendoj se administrata duhet me na e ba një raport, edhe me i përfshi sugjerimet duhet ti pranojmë por, ne duhet të ecim përpara...Por, vërejtët tona duhet me u përfillë...

### **3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

#### **1.Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Shqyrtimi dhe miratimi i specifikimeve teknike për shtypjen e fletëvotimeve:

**Alim Rama**: Në mbledhjen e KOZ jemi njoftuar me listën preliminare votuese. Për zgjedhjet e 18 dhjetorit, janë gjithsej 44 9 54 votues. Është një diferencë prej 1204 votues në krahasim me zgjedhjet e kaluara mirëpo, në raport i keni të dhënat konkrete. Mbi bazë të listës, bëhen edhe specifikat...

Rama, po ashtu foli për përgatitjet që dalin nga ky pozicion, rreth formatit të fletëvotimit etj. Ai, tha se do të shtypen rreth 45 000 fletëvotime...

Në parim, jemi dakordue...

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për miratim...?

Me 10 vota për, miratohen specifikat teknike për shtypjen e fletëvotimeve me ndryshim që do të bëhen pasi që do të shpallen zgjedhjet për asamble në komunat Leposaviq dhe Zveqan.

## **2.Këshilli për Çështje Ligjore:**

Njoftim për zëvendësim të anëtareve të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut, dhe Zubin Potok:

**Sami Hamiti:** Unë e kam një njoftim! Këshilli është takuar sot dhe pas rekomandimeve që kemi marrë nga ministria MAPL-së për zëvendësimin e anëtarëve në dy komuna, në Mitrovicën e Veriut dhe në Zubin Potok, e kemi shqyrtuar në këshill dhe janë plotësuar të gjithë formularët nga Sekretariati që, t'ju dorëzohen përmes zyrtarëve tanë subjekteve politike por edhe zëvendës kryesuesve; të plotësohen deklaratat për pranimin e mandatit...

Në momentin që kryhet kjo punë, që plotësohen këto materiale dhe kthehen, ne do t'i shqyrtojmë në KQZ...

**Kreshnik Radoniqi:** Mirë, a ka dikush tjetër diçka...? A ka diçka urgjente...?

**Burim Ahmetaj,** po, më datën 24 duhet të mbajmë mbledhje sepse, duhet ta bëjmë emërimin e KKZ-ve...

Mundemi të enjten, paradite më 24 nëntor...

**Kreshnik Radoniqi:** Për shkak që unë nuk jam, Arianiti më zëvendëson...